



THE AIRE CENTRE
Advice on Individual Rights in Europe



**REGIONAL
ANTI-CORRUPTION
INITIATIVE**

Rast Studimi

Kosoves

- Konfiskimi nga palë të treta -



Ky rast i konfiskimit është perzgjedhur si konfirmim i efikasitetit të zbatimit të ligjislacionit penal në Republikën e Kosovës, perkatesisht ligjeve pozitive si: Kodi Penal (KPRK-së), Kodi i Procedurës Penale (KPPRK-së), Ligji për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskim, Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit, me qëllim të ndeshkimit dhe parandalimit të fitimit të pasurisë nepermjet aktivitetit kriminal dhe në mënyrë të kundërligjshme, me theks të vecantë tek kryerësi i veprave penale, e që në këtë rast është profil i lartë.

Ish-gjykatësi K.P., më 28 qershor të vitit 2018, ishte dënuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë me katër vite e gjashtë muaj burgim efektiv, 5.000 euro gjobë dhe ndalim i ushtrimit të funksioneve publike për tre vjet, për veprat penale “nxjerrje e paligjshme e vendimeve gjyqësore, neni 432 të KPRK-së”, “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, neni 422 të KPRK-së”, si dhe “pastrim i parave, neni 56 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit”, ndërsa ishte liruar për “shmangie nga tatami, neni 313 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-se”.

Këtë aktgjykim të Gjykatës Themelore në Prishtinë, në pjesën më të madhe të tij e kishte vërtetuar edhe gjykata e shkallës së dytë, e cila të akuzuarit i kishte shqiptuar një dënim më të butë, ashtu që të akuzuarin K.P., e kishte gjykuar me burgim në kohëzgjatje prej tre vite e gjashtë muaj burgim dhe 3.000.00 euro gjobë.

Mirëpo, Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, të mbajtur më 15 maj 2018, ka miratuar pjesërisht kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, të mbrojtësit, të dënuarit K.P., dhe ka anuluar pjesërisht aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, dhe aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, vetëm përkitazi me veprën penale pastrimi i parasë, dhe çështja i është kthyer gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Pjesa tjetër e aktgjykimit është ndryshuar vetëm përkitazi me dënimin e shqiptuar, ashtu që për veprën penale nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore nga neni 432 të KPRK-së, dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muaj, e merr si të vërtetuar, kurse për veprën penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, po ashtu e merr si të vërtetuar, ashtu që i shqipton dënim unik burgimi, në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite e 4 (katër) muaj. Gjykata Supreme ia ka zbutur dënimin ish-gjykatësit K.P për dy muaj më pak.

Ky proces gjyqësor është zhvilluar në bazë të aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, PPS.NR.22/09, e cila ishte ngritur më 29 dhjetor të vitit 2015.



Sipas pikës 3 të aktakuzës, për të cilën pikë edhe ishte kthyer lënda në rivendosje, K.P., ngarkohet më veprën penale të pastrimit të parave.

Sipas aktakuzës, gjatë viteve 2002 – 2008, duke qenë i vetëdijshëm që paratë ishin produkt i aktivitetit kriminal, dhe me qëllim të fshehjes së prejardhjes së parave në vlerë prej 1.200.000 euro, kishte blerë prona të ndryshme.

Në aktakuzë thuhet se K.P., në Klinë kishte blerë dy apartamente, një lokal dhe një ndërtesë dy katëshe, në Mal të Zi, kishte blerë dy parcela, ndërsa në Prishtinë, në lagjen “Ulpiana”, kishte blerë një apartament.

Rasti për krim të organizuar ndaj ish-gjykatësit K.P., dhe pesë avokatëve, të cilët po akuzohen për vepra penale që lidhen me korrupsion dhe krim të organizuar, ka kaluar në Departamentin Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Me ish gjyqtarin K.P, pjesë e kësaj akuze janë edhe avokatët Z.M., L.P., I.S., F. M.,B. N., ku këta tre të fundit kishin qenë edhe përfaqësues të kompanive të sigurimeve.

Aktakuza e PSRK-së, lidhur me këtë rast përmban veprat penale “krim i organizuar”, “nxjerrja të kundërligjshme të vendimeve gjyqësore” “keqpërdorim të pozitës apo autorizimit zyrtar”, “mashtrimi” dhe vepra tjera penale. Ata akuzohen se me veprimet e tyre kundërligjore kanë përfituar mbi një milion euro (1.200.000 euro).

Aktakuza e parë për këtë rast ishte ngritur më 12 dhjetor 2013, ndërsa ishte precizuar me 14 nëntor 2014, 30 qershor 2017 dhe 14 gusht 2017.

Sipas aktakuzës, të gjithë të pandehurit kishin marrë pjesë në grupin e strukturuar kriminal i cili ka vepruar në kohë dhe hapësirë të caktuar e që objekt sulmi kanë qenë kompanitë e sigurimeve që kanë qenë duke vepruar në Republikën e Kosovës.

Këtë grup kriminal, aktakuza thotë se e ka krijuar, udhëhequr, mbikëqyrur e kontrolluar ish-gjykatësi i Klinës, K.P.

Sipas aktakuzës, K.P., arriti të krijoj marrëveshje me anëtarët e grupit kriminal që të imagjinojnë raste gjyqësore, të nxjerrin vendime të kundërligjshme, të falsifikojnë dokumente, të paraqesin rrejshëm fakte, të keqpërdoret pozita apo autoriteti zyrtar, si dhe të mos respektohet kompetenca gjyqësore. E krejt kjo me qëllim që të ketë përfitim të kundërligjshëm të mjeteve financiare me vlera të mëdha, në dëm të të tjerëve në kohë sa më të shpejtë dhe sa më të lehtë.

Sipas aktit akuzues, K.P., kishte lidhur marrëveshje për përfitim të kundërligjshëm me avokatë të cilët ishin të parët në zinxhirin e aktivitetit kriminal pas K.P.,si Z.M, dhe L.P.



Në aktakuzë thuhet se Z.M., i ka dhënë autorizim K.P., që të ketë qasje në xhirollogarinë e tij bankare, përmes të cilës ka operuar me vlera të mëdha në mënyrë të kundërligjshme. Pastaj, është lidhur marrëveshje me përfaqësuesit e Kompanive të Sigurimeve në mënyrë që gjatë shqyrtimit gjyqësor të pajtohen me propozimet-vendimet e K.P., nga pozita e gjyqtarit si I.S., F.M., dhe B.N., më tutje, aktakuza thotë se u krijua marrëdhënie edhe me mjekët specialistë, kryesisht të ortopedisë si tani të ndjerin dr.B.B.

Ky aktivitet, sipas aktakuzës, ka zgjatur nga viti 2004 deri në vitin 2008. Me këtë aktivitet, sipas aktakuzës, të pandehurit kanë ndarë mes vete në mënyrë të kundërligjshme vlerën prej 1.225.927.93 euro. Aktakuza thotë se me veprimet e të gjithë të pandehurve përmbahen elementet e veprës penale krim i organizuar.

K.P., akuzohet për nxjerrje të kundërligjshme të vendimeve gjyqësore e keqpërdorim të pozitës apo autorizimit zyrtar. Z.M., dhe L.P., akuzohen për keqpërdorim të besimit. F. M., dhe B.N., akuzohen për mashtrim dhe keqpërdorim detyre, si dhe I.S., akuzohet për keqpërdorim të pozitës apo autorizimit zyrtar.

Ndryshe, K.P, ka qenë i akuzuar edhe në një rast tjetër penal dhe i cili më 28 qershor të vitit 2017, është dënuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë me 48 muaj burgim efektiv, 5.000 euro gjobë dhe ndalim të ushtrimit të funksioneve publike për tre vjet.

K.P., ishte shpallur fajtor në tre nga katër pikat e aktakuzës për të cilat akuzohej. Për pikën e parë të aktakuzës, nxjerrje e vendimeve të kundërligjshme gjyqësore, K.P., është shpall fajtor dhe është dënuar me 18 muaj burgim. Për pikën e dytë të aktakuzës, keqpërdorim i pozitës zyrtare, vepër e cila u rikualifikua për shkak se është ligj më i favorshëm, gjykata e kishte shpallur K.P., fajtor dhe e ka dënuar me 24 muaj burgim.

Ish-gjyqtari K.P., ishte gjetur fajtor edhe për pikën e tretë të aktakuzës, pastrim i parave, dhe ishte dënuar më 18 muaj dhe 5.000.00 euro dënim me gjobë.

Ndërkohë, për veprën penale të shmangies nga tatimi, gjykata e kishte shpallur K.P të pafajshëm. Kurse, më 14 dhjetor të vitit 2017, Gjykata e Apelit ia kishte vërtetuar dënimin me burgim ish-gjykatësit K.P.

Nga i akuzuari janë konfiskuar paluajtshmëritë e përfituara nga kryerja e veprës penale më vlerë mbi një milion euro (1.000.000.00) dhe atë, një banesë në Klinë, një banesë në Prishtinë, patundshmëria (në të cilën është e ndërtuar një shtëpi) në Ulqin, të Malit të Zi, në sipërfaqe prej 308 m², patundshmëria (livadh) po në Ulqin, në sipërfaqe prej 171 m², një lokal afarist në Klinë, një automjeti "Audi A6", si dhe mjetet financiare nga shtija e dy lokaleve afariste.

Po ashtu, ish-gjykatësi K.P., me 4 shkurt 2019, është shpallur fajtor nga Gjykata Themelore në Prishtinë edhe për pastrim të parave dhe është dënuar me një vit burgim dhe me 3.000 euro gjobë.



THE AIRE CENTRE
Advice on Individual Rights in Europe



**REGIONAL
ANTI-CORRUPTION
INITIATIVE**

Ky aktgjykim ishte shpallur nga gjykatësja N.K., pasi I pandehuri ishte gjetur fajtor se gjatë viteve 2004 – 2008, duke qenë i vetëdijshëm që paratë ishin produkt i aktivitetit kriminal dhe me qëllim të fshehjes së prejardhjes së parave në vlerë prej 1.200.000 euro, kishte blerë prona të ndryshme.